



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:054411

Datë: 05.11.2019

Numri i dokumentit: 00627392

PKR.nr. 06/2013

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale të të pandehurit **K.Sh. dhe P.I.** për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273, parag. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe në dispozitivin II të aktakuzës, ndaj të akuzuarve **F.E. dhe S.R.**, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275, parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti për Krimet e Rënda, PPH./I.nr.228/2013 e dt.12.11.2013 e pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik me dt.01.11.2019 shpall, ndërsa me datë 04.11.2019 përpilon këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehuri K.Sh., nga babai T. dhe nëna R., e lindur Q., i lindur më ..., në Gjilan, me banim në rr. "P..." nr.142, në Gjilan, i martuar, Baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion rrobaqepës, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR SEPSE

I pandehuri K.Sh. më datë 25.07.2013, rreth orës 17:00, në Gjilan, në lokalin e rrobaqepësisë "K...", pronë e të pandehurit K.Sh., në bashkëveprim me të pandehurin P.I., pa autorizim kanë poseduar dhe shitur substancë narkotike të llojit "Marihuan", ashtu që të njëjtën ditë, në lokal hyjnë të pandehurit F. E. dhe

S.R. dhe nga i pandehuri K. Kërkojnë substancë narkotike, merren vesh me të njëjtin, i pandehuri S. i paguan çmimin prej 20 euro, më vonë kthehen dhe nga i pandehuri Premtim i marin 20 gr substancë narkotike “Marihuanë”, dhe më pas diku rreth orës 21:00, të pandehurit F. E. dhe P.I., kërkojnë prapë “Marihuanë” për shumën prej 100 euro, ia japin të hollat të njëjtit, dhe pasi që i pandehuri Premtim merret vesh me të pandehurin K., e merr çelësin nga i njëjti, dhe nga Policia e Kosovës –DHTN, para lokalit “K...” nga premtim I. sekuestrohen 387.2gr Marihuanë.

-me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

- Andaj, në bazë të nenit 4, 41, 42, 43,45, 46, 69, 73, 74, 75, 76 dhe 80 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, neni 365 dhe 450 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

E GJYKON

Me dënim me gjobe ne shume prej **500,00 (pesëqind) euro** dhe me dënim me burg në kohëzgjatje prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) dite**, i cili dënim me burg **me kërkesën e te akuzuarit** i zëvendësohet me dënim me gjobe ne shume prej **2.500 (dy mije e peseqind) euro**, **ashtu qe te pandehurit i shqiptohet dënim unik me gjobe ne shume prej 3.000,00 (tremijë) euro**, i cili denim do të ekzekutohet pas kalimit te afatit prej 15 ditëve nga plotfuqishmëri se këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor kësaj gjykate t’i paguajë shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe 50 euro për kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

Konfiskohen 387.2 gram të substancës narkotike e llojit “Marihuanë” të cilat i janë gjetur ne lokal të të pandehurit K.Sh. dhe e njëjtat pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi do te asgjësohen.

Veqohet procedura penale ndaj të pandehurve P.I. dhe F.E..

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, më 12.11.2013 ka ngritur aktakuzën PP./I.nr. 228/2013, në Dispozitivin I ndaj të **akuzuarve K.Sh. dhe P.I.** për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273, parag. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe në dispozitivin II të aktakuzës, ndaj të akuzuarve **F.E. dhe S.R.**, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275, parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurit t'i shpallë fajtorë dhe t'i shqiptojë dënim të merituar sipas ligjit dhe t'i konfiskojë sasinë e substancave narkotike të cilat iu janë gjetur të pandehurve.

Kryetari i trupit gjykues, më 31.10.2019 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku fillimisht ka konstatuar se ndajë të pandehurit S.R. është vendosur me Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda **PKR.nr. 656/2013 të d.t 08.01.2018**, dhe me propozimin e Prokurorit të Shtetit është veçuar procedura ndaj të pandehurve P.I. dhe F.E., për shkak të ekonomizimit të procedurës.

Më pastaj është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të saj i pandehuri K.Sh., ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i kërkon falje gjykates dhe se nuk do ta përsëris, gjithashtu deklaroi se pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare pa imponime, duke i ditur pasojat e pranimit të fajësisë e pas konsultimit me avokatin e tij mbrojtës .

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, ngase janë plotësuar kushtet ligjore, ky pranim i fajësisë është vullnetar, pa imponim, duke i ditur pasojat e pranimit të fajësisë, në përputhje me provat që gjinden në shkresat e lëndës: **Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve në emër të të pandehurve S.R. e F.E., me nr. 2013-DHTN-0190, të dt. 25.07.2013, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve në emër të të pandehurit Premtim Ibishi, me nr. 2013-DHTN-0190, i dt. 25.07.2013, Testi fushor me nr. 2013-DHTN-190.**

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, konform dispozitave 73, 74 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjykata ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt kryetari i trupit gjykues si rrethana lehtësuese për të pandehurin ka marrë pranimin e fajësisë, pendimin dhe kërkim faljen për kryerjen e kësaj vepre penale dhe premtimin e të pandehurit që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale, ndërsa nuk gjeti rrethana rënduese për të pandehurin.

Sipas kryetarit të trupit gjykues, dënimi me gjobë në shumë prej 500 euro dhe me burg në kohëzgjatje prej 180 dite, i cili dënim me kërkesën e të pandehurit është zëvendësuar me dënim me gjobe në shume prej 2.500 euro dhe pastaj të pandehurit i është shqiptuar dënim unik me gjobe në shume prej 3.000 euro, është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe gjendjen financiare të tij, andaj konform nenit 41 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjykata vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston në parandalimin e kryesit që në të ardhmen të kryejë vepra tjera penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-se, të pandehurit i ka konfiskuar 273 gram të substancës narkotike ë llojit “Marihuanë” të cilat i janë gjetur të në lokal të të pandehurit K.Sh. dhe e njëjtat pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi do të asgjësohen.

Kryetarit i trupit gjykues ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate t’i paguajë shumën paushalle në vlerë prej 20 (njëzet) euro, si dhe 50 euro për kompenzimin e viktimave të krimit ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**

Më 04.11.2019

**Sekretarja juridike
Fikrete Destani**

**Kryetari i trupit gjykues
Naser Maliqi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.